Në bazë të kërkesës së Kryetarit të Komunës, të dt.12.03.2025, nr.01-6932, për ndarjen e parcelës 00563-24 Z.K. Deçan për ndërtimin e njësive të reja banesore për Banim Social dhe Banim të Përballueshëm në Deçan- duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Deçanit-Për projektin e Banimit Social Adekuat Nr.02-43198, dt.30.12.2024 dhe në thirrjen e MMPHI për Projektin për Banim të Përballueshëm, në pajtim me dispozitat e nenit 10, 11 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), në bazë të nenit 22 dhe 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024-2032 01.Nr.I-8, të dt.27.02.2025, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.03.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E PARCELËS PËR NDËRTIMIN E NJËSIVE TË REJA BANESORE PËR BANIM SOCIAL DHE BANIM TË PËRBALLUESHËM NË DEÇAN

I.

Miratohet Vendimi për ndarjen e parcelës për ndërtimin e dy objekteve: 1. Ndërtimin e Njësive të reja banesore për Banim Social dhe 2.Ndërtimin e Njësive banesore për Banim të Përballueshëm në Deçan.

II.

Parcela e caktuar për ndërtimin e dy objekteve: 1. Ndërtimin e Njësive të reja banesore për Banim Social dhe 2.Ndërtimin e Njësive banesore për Banim të Përballueshëm në Deçan, është pjesë nga Parcela Nr.00563-24, me sipërfaqe të përgjithshme S=86,619.2 m^2, Njësia Kadastrale P-70505021-00563-24, sipërfaqja e ndarë për ndërtim sipas këtij vendimi është S=20,000 m^2, Zona Kadastrale Deçan, pronar Komuna e Deçanit, si dhe është në harmoni me Dokumentin e planifikimit hapësinorë të Komunës së Deçanit "Plani Zhvillimor Komunal-PZHK 2024-2032", 01.Nr.I-8, të dt.27.02.2025, parcelë e planifikuar në PZHK për banim, brenda Zonës Urbane.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi do ta kujdesen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Skica grafike,
- Kopjet e planit dhe
- Certifikata e njësisë kadastrale.

K.K. DEÇAN AJ 8676
01 10.04.25

VI.

Vendimi iu dërgohet : Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivit të Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-2
Deçan,dt.28.03.2025

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DECAN

02. Zyra e Kryetarit

Nr-
Dt. 19.03.2025

Për/To/Za :	**ASAMBLENE KOMUNALE**
Nga/From/Od :	**Z.Bashkim RAMOSAJ, Kryetari i Komunës**
Tema/Subject/Subjekat	**Kërkesë për ndarjen e parcelës 00563-24 Z.K.Decan per Ndertimin e njësive te reja banesore per Banim Social, dhe Banim te Përballueshëm**

Te nderuar asambelistë,

Duke u nisur nga kërkesat e banoreve për banim social dhe banim te përballueshëm, duke u bazuar ne memorandumin e mirëkuptimit ne mes MMPHI dhe Komunës Deçan - Per Projektin e Banimit Social Adekuat nr.02.43198 dt.30.12.2025, dhe ne thirrjen e MMPHI për Projektin për Banim te Përballueshëm :

Kërkoj nga ju të merret një vendim për ndarjen e hapësirës me rreth **20,000 m² ne parcelën kadastrale 00563-24 Z.K.Decan** me sipërfaqe totale 86,619.2 m² në mënyrë që të mundësohet plotësimi i dokumentacionit te nevojshëm për ndërtimin e dy objekteve përkatësisht: 1.Ndertimi i njësive banesore te reja per banim social dhe 2.Ndërtimi i njësive banesore për banim te përballueshëm.

t. Kryetari 6932
01 19.03.25

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : DEÇAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Deçan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-70505021-00563-24	Parcelë / Parcela / Parcel	77665



Shkalla/Razmera/Scale: 1:4017

Punoi/Obradio/Created: Valentina Mushkolaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 19.03.2025

Koha/ Vreme/ Time: 03:04:16

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70505021-00563-24

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	**12-6931/2025**
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	19.03.2025 - 11:25
Komuna / Opština / Municipality:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Deçan / Deçan / Deçan
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70505021-00563-24	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Urban	77665	Aktvendimi i zyres Kadastrale ne Deçan nr.12-13-2024	30.01.2024	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Podi i Gështenjave			30.01.2024	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pašnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture	**77665**

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	**Komuna e Deçanit**	600325668	/ / /		JASHAR SALIHU	**1/1**	7-2005	30.01.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktrës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

DEÇANI

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova

Komuna e Deçanit
Opština Decani
Municipality of Deçan

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: OA-M
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 8502/24
Nr. i Faqeve / Br Stranica / No.Pages: -OC-
Data: / Datum: / Date: 24.12.24
PRISHTINË / A No. 1

Z. KRYETARIT 43198
02 30.12.24

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES

MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

DHE

KOMUNËS SË DEÇANIT

PËR

PROJEKTIN E BANIMIT SOCIAL ADEKUAT

Prishtinë
Dhjetor, 2024

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt.18.11.2022), Shtojcës 1, pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin "Banimi Social Adekuat", neni 19 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, dhe 1.3, neni 24, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Kodi i Projektit 18987 - Programi i Banimit Social të paraparë në Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 (Gazeta Zyrtare, Nr. 22/2024 dt.12 Dhjetor 2024), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr.28/04 Qershor 2008), si dhe Thirrjes Publike me Nr.314 të datës 06.12.2024 për Shprehje Interesi për Komunat e Republikës së Kosovës, për Projektin e Banimit Social Adekuat, palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e përfaqësuar nga z. **Liburn Aliu** - Ministër (në tekstin e mëtejmë MMPHI);

dhe

2. Komuna e Deçanit, e përfaqësuar nga z. **Bashkim Ramosaj** - Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejmë Komuna)

lidhin:

MEMORANDUM TË MIRËKUPTIMIT PËR PROJEKTIN E BANIMIT SOCIAL ADEKUAT

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejmë "Memorandumi") është të krijoj lidhje bashkëpunimi në mes MMPHI-së dhe Komunës për realizimin e Projektit të Banimit Social Adekuat (në tekstin e mëtejmë "Projekti").

2. Realizimi i Projektit bëhet përmes nën-projekteve[1] - kompontentëve të Projektit në Komunë të cilat synojnë të përmirësojnë kushtet e banimit për grupet e synuara sipas Programeve të Veçanta të Banimit [2] për familjet ose individët të cilët nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit ose njësitë e banimit nuk i plotësojnë kushtet elementare për banim dhe kanë nevojë për rindërtim ose renovim. Gjithashtu ky Projekt është në përputhje me politikat e MMPHI-së për zhvillimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në njërën anë, si dhe në funksion të ushtrimit të suksesshëm të përgjegjësive të hartimit, zhvillimit dhe menaxhimit të politikave, programeve dhe projekteve të banimit nga MMPHI dhe Komuna të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

[1] Nën-projektet në kuptim të këtij Memorandumi janë kategoritë e radhitura në nenin 2 paragrafi 2 të parapara në Marrëveshjen e kredisë e ratifikuar me Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë. Nën-projektet në Marrëveshjen e ratifikuar janë emëruar si Komponentët e Projektit (komp. 1 dhe komp. 2).

[2] Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Palët pajtohen që të përcaktojnë parimet e bashkëpunimit, rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të Projektit përmes nën-projekteve, në dobi të familjeve ose individëve të cilët kanë nevojë për ndihmën e shtetit, përmes zbatimit të Projektit për vitet 2025-2027.

2. Ky Memorandum ofron mundësi për Komunën që të përfitoj nga MMPHI financimin për realizimin e nën projekteve, të përzgjedhura nga Komuna pas shprehjes së interesit në "Thirrje për shprehje interesi për Komunat e Republikës së Kosovës për Projektin e Banimit Social Adekuat", si në vijim;

2.1. ☒ Ndërtimin e projekteve (njësive banesore) të reja për banim social;
2.2. ☒ Renovimin e njësive ekzistuese të banimit social;
2.3. ☒ Rindërtimin apo renovimin e shtëpive private për familjet e cenueshme.

Neni 3
Mënyra e financimit

1. MMPHI, do të sigurojë financimin[3] e nevojshëm për Komunën për realizimin e Projektit përmes nën-projekteve sipas Ligjit Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin "Banimi Adekuat Social" dhe Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 dhe 2027.

2. Financimi nga MMPHI dhe shuma për Komunën për zbatimin e Projektit përmes nën-projekteve, sipas paragrafit 2 të Nenit 2 të këtij Memorandumi, do të përcaktohet pas shqyrtimit të projekt-propozimeve dhe aplikimeve nga Komuna, vizitave në terren, koordinimit me palët përkatëse dhe hartimit të raporteve për miratim të projekt-propozimeve nga aplikimi.

Neni 4
Përgjegjësitë e MMPHI-së

1. MMPHI, ka përgjegjësi për:

   1.1. Koordinimin, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin për shpërndarjen dhe përdorimin e financimit të nën projekteve në përputhje me rregulloret dhe procedurat sipas Marrëveshjes së kredisë e ratifikuar me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës

   (BZHKE) për projektin "Banimi Social Adekuat përmes Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP);

   1.2. Nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi pas aprovimit të propozimeve për

[3] Financimi për Komunat dedikohet vetëm për investime kapitale

nën-projekte, në mes MMPHI-së dhe Komunës, ku do të specifikohen detyrat dhe përgjegjësitë për implementimin e tyre;

1.3. Revidimin e nën-projekteve të hartuara nga Komuna;

1.4. Mbështetjen dhe asistencën teknike përmes NjMP për Njësitin Implementues të Projektit (NjIP) të Komunës për realizimin e Projektit.

Neni 5
Përgjegjësitë e Komunës

1. Komuna, ka përgjegjësi për:

1.1. Themelimin e Njësitit Implementues të Projektit (NjIP);

1.2. Dorëzimin e propozim projektit pranë MMPHI-së;

1.3. Plotësimin e kushteve sipas dokumenteve të planifikimit dhe të gjitha kushteve të infrastrukturës për lokacionin e përzgjedhur në rastin e ndërtimit të projekteve të reja të banimit social, përfshirë rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, infrastrukturën rrugore dhe shërbimeve tjera të nevojshme për implementimin adekuat të Projektit përmes nën-projekteve;

1.4. Hartimin e Termave të Referencave dhe Detyrës Projektuese bazuar në Manualin e Zbatimit të Projektit (MZP);

1.5. Zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimin e tenderimit të Projektimit (Shërbime arkitekturale inxhinierike profesionale-Projektim), koordinimin dhe menaxhimin e hartimit të gjitha fazave të projektit urb-arkitektural, zgjidhjen urbane, projektin konceptual, projektin ideor dhe projektin kryesor-zbatues ose projekte për renovim dhe rindërtim të njësive të banimit me kompaninë projektuese të kontraktuar dhe financuar nga Komuna;

1.6. Zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimin e tenderimit për mbikëqyrje të punimeve për ekzekutimin e Projektit përmes nën-projekteve me kompaninë e mbikëqyrjes, të kontraktuar dhe financuar nga Komuna;

1.7. Zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimin e tenderimit për ekzekutimin e punëve ndërtimore të Projektit përmes nën-projekteve;

1.8. Caktimin me autorizim të një zyrtari në nivel komunal për të lehtësuar komunikimin e palëve për rastet e dorëzimit të Projektit për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore, Certifikatës së Përdorimit dhe procedura tjera relevante të parapara sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi;

1.9. Koordinimin dhe bashkëpunimin në mënyrë efektive me MMPHI përmes NjMP, për mbarëvajtjen e hartimit dhe zbatimit të Projektit duke siguruar në mënyrë transparente të gjitha informatat për zhvillimin e Projektit pa vonesa, brenda afateve ligjore dhe procedurave për pajisje me Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Certifikatën e Përdorimit, sipas kategorive të Projektit;

1.10. Akomodimin e përfituesve deri në përfundimin e punimeve të renovimit;

1.11. Dorëzimin e raporteve pranë NjMP-së në kuadër të MMPHI-së, sipas udhëzimeve dhe formateve të raportimit nga MZP;

1.12. Administrimin dhe menaxhimin, përfshirë përditësimin e rregullt për të dhënat e pëfituesit dhe kërkesave të reja si dhe mirëmbajtjen sipas legjislacionit në fuqi të njësive të banimit të realizuara nga Projekti sipas nën-projekteve.

Neni 6
Kriteret e përzgjedhjes së përfitueseve

1. Përfituesit do të përzgjidhen sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Mundësi përfitimi do të kenë familjet ose individët me të ardhura të ulëta deri të mesme, si dhe grupet e cenueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe prindërit vetë ushqyes.

Neni 7
Standardet teknike

Standardet dhe normat teknike për Projektin e zhvilluar, do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të përcaktuara për secilin nën-projekt dhe të specifikuara gjerësisht përmes MZP.

Neni 8
Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MMPHI-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet apo plotësohet.

2. MMPHI-ja mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast të konstatimit se Komuna nuk i përmbushë obligimet e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 9
Zgjidhja e kontesteve

Palët janë pajtuar në mes vete që ky Memorandum zgjidhet me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore, mosmarrëveshja do të zgjidhet përmes mekanizmave të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10
Numri i kopjeve

Memorandumi është nënshkruar në katër (4) kopje, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum është i vlefshëm nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e suksesshëm të Projektit.

2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim ose përditësim të nevojshëm që ndikon në zbatimin e Projektit dhe në përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Memorandum.

Për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës:

Liburn ALIU
Minister i MMPHI-së

Për Komunën e Deçanit:

Bashkim RAMOSAJ
Kryetar i Komunës së Deçanit

Datë: **23 Dhjetor 2024** , Prishtinë

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, në bazë të nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 3, nenit 4 paragrafi 2 pika 2.4.3.1 dhe nenit 7 të Ligjit nr.03/L-205 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. NR.03/l-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 91 / 10 dhjetor 2010, me propozimin e Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.28.03.2025, miraton këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES PUBLIK PARCELA NR.00094-0 DHE INICIMI PROCEDURËS SË SHPRONËSIMIT

I.

Me këtë Vendim SHPALLET pronë me interes publik, me qellim te përfitimit publik në Komunën e Deçanit, parcela kadastrale 00094-0, me sipërfaqe 869 m^2, Zona Kadastrale Lëbushë e evidentuar si Pronë private e pronarit Muhamet (Kadri) Kastrati.

II.

Ngasrta Kadastrale shpallet interes i përgjithshëm publik më qëllim të zbatimit të projektit " Zgjërimi i rrugës, urave dhe strukturave nga Deçani dalja për Pejë, segmenti Lëbushë-Qendra e Strellcit".

III.

Në bazë të këtij Vendimi për shpalljen e Pronës me interes publik komunal në komunën e Deçanit, do të fillon edhe procedura e shpronësimit në harmoni me dispozitat e Ligjit nr.03/L-205 Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, për ngastrën e cila është konstatuar nga ekspertët e fushës se është atakuar gjatë zbatimit në plotëni të projektit "Zgjërimi i rrugës, urave dhe strukturave nga Deçani dalja për Pejë, segmenti Lëbushë-Qendra e Strellcit".

Për zbatimin e këtij Vendimi do ta kujdesen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

K.K. DEÇAN AS 8675
01 10.04.25

V.

Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Kopjet e planit dhe
- Certifikata e njësisë kadastrale.

VI.

Vendimi iu dërgohet : Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivit të Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-5
Deçan,dt.28.03.2025

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

PROPOZIM

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 3, nenit 4 paragrafi 2 pika 2.4.3.1 dhe nenit 7 të Ligjit nr.03/L-205 Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj i propozon Kuvendit të Komunës së Deçanit në mbledhjen që do të mbahet me dt.28.03.2025, këtë:

PROPOZIM-V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES PUBLIK DHE INICIMI PROCEDURËS SË SHPRONËSIMIT TË TË NJEJTËS PRONË

I.

TË SHPALLET pronë me interes publik, me qellim te përfitimit publik në Komunën e Deçanit, parcela kadastrale 00094-0 e cila nevoitet për zbatimin e projektit " **Zgjërimi i rrugës, urave dhe strukturave nga Deçani dalja për Pejë, segmenti Lëbushë-Qendra e Strellcit"**, me sipërfaqe 869 m^2, Zona Kadastrale Lëbushë, e evidentuar si Pronë private e pronarit Muhamet (Kadri) Kastrati.

II.

Në bazë të këtij Vendimi për shpalljen e Pronës me interes publik komunal në komunën e Deçanit, do të fillon edhe procedura e shpronësimit në harmoni me dispozitat e të Ligjit nr.03/L-205 Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, për ngastrën e cila është konstatuar nga ekspertët e fushës se është atakuar gjatë zbatimit në plotëni të projektit "**Zgjërimi i rrugës, urave dhe strukturave nga Deçani dalja për Pejë, segmenti Lëbushë-Qendra e Strellcit"**.

III.

Propozim Vendimi i dërgohet Kuvendit të Komunës.

Deçan,dt.25.03.2025

Kryesuetari i Komunës
Bashkim RAMOSAJ



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70511057-00094-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	**12-41600/24**
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	13.12.2024 - 10:53
Komuna / Opština / Municipality:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Lebushë / Lebushë / Lebushë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70511057-00094-0	**PARCELË / PARCELA / PARCEL**	Pronë private / Privatna Imovina / Privatelly owned Land	Rural	**869**			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
RRETHI I HASANAJ-NER DRUM				

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 2/Njiva 2 Klase/2nd Class Arable Land	869

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	**Kastrati Muhamet (Kadri)**	1173538479	PEJË / PEĆ / PEJË /		Rr. Mbreti Bardhyl A1 Nr.7	1/1	12-395/24	30.09.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : DEÇAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lebushë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-70511057-00094-0	Parcelë / Parcela / Parcel	869



Shkalla/Razmera/Scale: 1:462

Punoi/Obradio/Created: Valentina Mushkolaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 13.12.2024

Koha/ Vreme/ Time: 10:53:54

TEB [redacted]

Date : 19-MAR-2025

[redacted]

Account Type	:	Current
[redacted]		
Currency	:	EUR
Int. Rate	:	%.....
Beg.Of Mat.	:	.....
Maturity	:	.....
Overdraft Account Limit	:	[redacted]



Signature (Personnel)

Signature (Customer)


REPUBLIKA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
Date of birth
M
ID


Date of issue
MPB / MUP / MIA
Personal No.

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2, shkronja (d), nenit 17 shkronja (o), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Nenit 11 të Ligjit Nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.14/2019 për Caktimin e Emërtimit dhe Numërtimit të Adresave për Zona të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të lira, si dhe nenit 26 pika 6 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi Komunal Deçan, pasi analizoi listën rezervë të propozuar nga Komisioni Komunal për emërtimin, dhe riemërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit, Procesin e diskutimit publik nëpër fshatra dhe bashkësitë e qytetit të Deçanit, **si dhe në bazë të shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të dt.19.03.2025 Nr.1488-2/25 për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit, Kuvendi i Komunës së Deçanit pasi Rishqyrtoj Vendimin, 01.Nr.I-7 të dt.27.02.2025 për miratimin e Listës me Emra Rezervë të Rrugëve të Komunës së Deçanit,** në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2025, miratoi këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E LISTËS REZERVË ME EMRAT E RRUGËVE TË APROVUARA SIPAS FSHATRAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

I.

Me këtë Vendim Aprovohet Lista Rezervë me emrat e rrugëve të aprovuara sipas fshatrave në Komunën e Deçanit, sipas kësaj tabele:

Fshatrat	Nr	LISTA REZERVË ME EMRAT E RRUGËVE TË APROVUARA SIPAS FSHATRAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT
Beleg	1	Fatmir Vishaj
Belle	2	Marash Pali
	3	Hasan Beqiri
	4	Hazir Laha
	5	Ali Lulaj
	6	Naim Shala

	7	Bajram Meta
	8	Lul Giga
	9	Nysret Shala
	10	Himë Zeqiri
	11	Col Sokoli
	12	Lan Halili
	13	Zeqir Ahmeti
	14	Smajl Demushi
	15	Demush Tahiri
	16	Zenel Çekaj
	17	Gilë Martini
Carrabregi i Ulët	18	Elez Dema
Carrabregu Epërm	19	Xhavit Dobraj
	20	Bajram Lataj
	21	Xhemajl Rexha
	22	Azllan Balaj
	23	Zeqë Rexha
	24	29 Maji
	25	Kodra e Loshit
	26	Tahir Cena
	27	Zenel Balaj
Dashinoc	28	Besart Kadrijaj
	29	Ali Mustafaj
	30	Xhafer Cacaj
Deçan	31	Kamer Homza
	32	Halil Sejfijaj
	33	Ura e Lumbardhit
	34	Nezir Bardhi
	35	Sadri Tolaj
	36	Jeta
	37	Bilall Demukaj
	38	Ukë Iberhysaj
	39	Rexhep Iberhysaj
	40	Halim Tolaj
Dubovik	41	Brahim Zeqiri
	42	Musa Shala
	43	Agush Shala

Irzniq	44	Spitali ushtarak
	45	Mësuesja Fatime
	46	Isat Mushkolaj
	47	Ramë Zejnaj
	48	Col Dervishaj
Isniq	49	Isuf Tafaj
	50	Shaban Sadiku
	51	Haxhi Bajraktaraj
	52	Hysen Tahirsylaj
	53	Halil Rama
	54	Zenun Mulaj
	55	Ramadan Demushi
	56	Ali Meta
	57	Metë Ahmetxhekaj
	58	Beteja Gushtit
	59	Miftar Balaj
	60	Selishta
	61	Xhevat Tahiri
	62	Xhemë Sinanaj
	63	Elvis Osadautaj
	64	Ramë Haxhnikaj
	65	Musë Tahiri
	66	Ukë Bojku
	67	Hysen Haxhia
	68	Emin Demushi
	69	Fazli Abazi
	70	Mustafë Haklaj
Lëbushë	71	Pavadave
	72	Shaim Musaj
	73	Mehmet Shabani
	74	Isuf Rrustemi
	75	Liria
Lloqan	76	Ali Rexha
	77	Rifat Rama
Llukë e Epërme	78	Sadri Brahimi
	79	Qerim Uka
	80	Isuf Sutaj
	81	Hoxhëve
	82	Nezir Meta
	83	Sylë Shaqa

	84	Rexhep Sokoli
	85	Tahir Efendi Lluka
	86	Isë Xani
Llukë e Ulët	87	Jashar Gecaj
Lumbardh	88	Rizë Lekaj
	89	Isuf Lokaj
	90	Ramadan Gashi
	91	Myshyr Barahimi
Maznik	92	Kushtrim Sylaj
Pemishtë	93	Selim Sokoli
	94	Haxhi Muhameti
Pobergjë	95	Ilir Tolaj
	96	Trimat e Vokshit
	97	Hasan Bajrami
	98	Naim Tolaj
	99	Bekim Tolaj
	100	Islam Avdia
	101	Isuf Sejdia
	102	Shtegtimi
	103	Brahim Shaqa
Prapaqan	104	Qazim Shala
	105	Ukë Ibishi
	106	Asllan Dina
	107	Mustafa Pejqinoviq
	108	Hisen Gecaj
	109	Bekë Lajqi
	100	Jashar Ahmetaj
	111	Bolloboshnica
Prilep	112	Kreshnik Qufaj
	113	Brahim Qufaj
	114	Ali Tolaj
	115	Musë Kukalaj
	116	Malë Kukalaj
	117	Isë Halili
	118	Bekë Hulaj
	119	Imer Rama
	120	Miftar Latifaj
	121	Musë Latifaj

Rastavicë	122	Blerand Hasimi
	123	Sadik Kadrijaj
	124	Batalioni Atlantiku
	125	Amir Bego
	126	Shefqet Sejda
Ratish i Ulët	127	Rexhep Hasanaj
	128	Ukë Ukaj
Strellc i Epërm	129	Elez Shabanaj
	130	Selmon Hasanramaj
	131	Jakub Demalijaj
	132	Brigada Mergimi
	133	25 Maji
	134	Isuf Milaj
	135	Ahmet Povataj
	136	Shaban Mahmutdemaj
	137	Selim Alimusaj
	138	Zeqir Povataj
	139	Halil Zenelaj
	140	Haxhë Shabanaj
	141	Mulliri Istrefaj
	142	Ali Hajdari
Strellc i Ulët	143	Demë Rabushaj
	144	Zhel Hylaj
	145	Arif Jusaj
	146	Mehmet Pajazitaj
	147	Bajram Pajzitaj
	148	Daut Hylaj
	149	Selman Elezaj
	150	Eshref Rabushaj
	151	Ali Dautaj
	152	Demë Balaj
	153	Osman Pajazitaj
	154	Xhavit Kamishaj
	155	Shaban Bajramaj
	156	Sejdi Balaj
	157	Halil Dautaj
	158	Ukë Qelaj
Gramaqel	159	Ali Avdiu
	160	Demë Dobraj

Voksh	161	**Beqir Agë Vokshi**
Pozhar	162	**Brahim Sokolaj**

II.

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive Komunale, Zyrës për informim, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Planifikimin Hapësinor, Agjensionit Kadastral të Kosovës si dhe Entit Statistikor të Kosovës.

01. Nr. II-7
Deçan, dt. 27.02.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. DEGANAS 8690
01 10.04.25

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenit 17 shkronja (s), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), si dhe nenit 15 pika 23, nenit 26 pika 19, nenit 28 paragrafi 1 pika 4, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.28.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN "QYTETAR NDERI" I KOMUNËS SË DEÇANIT GJENERALIN AMERIKAN, GJENERAL BRIGADE SHTZ ARTHUR GARFFER

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës dhe merret Vendim për shpalljen **"QYTETAR NDERI"** i Komunës së Deçanit, Gjeneralin Amerikan, **Gjeneral Brigade shtz.ARTHUR GARFFER.**

2. Me motivacion: **"Për kontributin e tij dhënë në vazhdimin dhe forcimin e miqësisë së përhershme me popullin dhe shtetin më mik që ka Kosova dhe populli shqiptarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe për kontributin e tij në ruajtjen dhe rritjen e sigurisë dhe stabilitetit politiko-ushtarak të Republikës së Kosovës.**

3. Me rastin e shpalljes, Kryetari i Komunës së Deçanit, do t'i dorëzojë Gjeneralit Amerikan, Gjeneral Brigade shtz. ARTHUR GARFFER. titullin "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit dhe do të regjistrohet në regjistrin e bartësve të titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Deçanit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Deçanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.II-6
Deçan, dt.28.03.2025

K.K Deçan AS 7639
01 28.03.25

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

